

Mr. Mark K. GJOKAJ, Ulqin

MALËSIA E MADHE NË VITET E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Lidhja Shqiptare e Prizrenit si një ndër ngjarjet më të rëndësishme jo vetëm në kohën e Rilindjes Kombëtare, është një fundament i ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe krijimit të shtetit shqiptar. Ajo pati përhapje të gjerë në të gjitha trojet shqiptare e në këtë kuadër u shtri edhe në Malësinë e Madhe.

Pjesa e dytë e shekullit XIX karakterizohet me ndryshime të mëdha në marrëdhëniet ndërkombëtare që kanë refleksione edhe në relacion me shqiptarët, sepse shënohen ndryshime politike, historike, ekonomike, kulturore etj. Paqja e Shën Stefanit, e nënshkruar mes Perandorisë Osmane dhe Rusisë, ishte dominim i kësaj të fundit ndaj Fuqive të Mëdha në kuadër të humbjeve turke, ishte vepër e Rusisë në favor të aleatëve të saj ballkanikë. Rusia kishte projektuar hartën e re politike të Ballkanit duke ia diktuar Turqisë kushtet e projektit të nënshkruar më 3 mars 1878. Marrëveshja ua jepte ose ua ndante tokat shqiptare Serbisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë. Malit të Zi i jepeshin Hoti, Gruda, Kelmendi, Vermoshi, Plava, Gucia, Rugova, Tivari me rrethina, vende të banuara ekskluzivisht me shqiptarë; Ulqini me rrethina deri te lumi Buna, Ana e Malit e Kraja (por i jepeshin edhe Koja, Fundenat dhe pjesa më e madhe e Triepshit-M.Gj) etj. Në kohën e këtyre ngjarjeve (pjesa e dytë e shekullit XIX) kriza e rendë ekonomike dhe politike që po përjetonte Porta e Lartë e shpiente atë në rrugën e shkatërrimit të pashmangshëm.

Pjesëmarrja e Malësisë së Madhe në Lidhjen e Prizrenit

Në dy raporte nga Shkodra, nr. 54-55 të 15 e 16 qershorit 1878, të kryekonsullit austro-hungarez Lippich thuhet: "Shkodra i merrte vesh shumë mirë ngjarjet e Prizrenit nëpërmjet qiraxhinjve, por edhe nëpërmjet telegrafistëve të alfabetit "mors" dhe këto lajme depërtonin në zyrat e diplomatëve të huaj". Përkrahësit e lëvizjes kombëtare, patriotët dhe revolucionarët e këtij Vilajeti gjatë muajve maj-qershor 1878 u ndodhën përballë një presioni të madh politik dhe administrativ të autoriteteve shtetërore në krye me valiun Hysen Pasha (Frashëri). Më 15 qershor 1878 kryekonsulli austro-hungarez Lippich shkruan: "Delegatët e Vilajetit të Shkodrës, të penguar nga intrigat e valiut Hysen Pasha, nuk ishin nisur ende për në Prizren". Megjithatë, ditën që u hap Kuvendi i Përgjithshëm, më 10 qershor 1878, qytetarët shkodranë myslimanë e katolikë së bashku me prijësit e viseve malore dhe banorët e qyteteve të tjera të Vilajetit njoftuan Prizrenin se do të marrin pjesë në Lidhjen e popullit shqiptar.

Presioni tjetër vinte nga Austro-Hungaria, nga përfaqësuesi i saj në Shkodër, kryekonsulli Lippich, i cili me përpjekjet e tijë mundohej të shkaktonte përçarje fetare "dhe përpiquej t'i bindte krerët katolikë të mos adhuronin asnjë lloj "besë-lidhjeje". Në qarqet përparimtare ishte e njohur se Shkodra dhe Dibra përbënin krahun më revolucionar të lëvizjeve kombëtare. Dhe, pikërisht nga Shkodra më 13 - 16 qershor 1878 dalin tri peticione: dy të Lëvizjes Kombëtare dhe një në frymë sulltaniste. Më 13 qershor 1878,

ditën e hapjes së Kongresit të Berlinit, ajo i drejton një memorandum ministrit të Jashtëm britanik, Lordit Bikonsfilld (Beaconsfield), ndërsa dy ditë më vonë, më 16 qershor 1878, " Protestën kundër synimeve ndaj tokave shqiptare" me nënshkrimin e përfaqësuesve të rretheve dhe krahinave të Shkodrës, Tiranës, Krujës, Lezhës, Krajës, Ulqinit, Grudës, Podgoricës, Shpuzhës, Zhabjakut (por edhe të Shkrelit, Kastratit, Kelmendit, Triepshit etj.-M. Gj.). Peticioni i parë ishte i nënshkruar nga 380 përfaqësues, kurse i dyti me frymë sulltaniste, që u përgatit sipas udhëzimeve të Hysen Pashës, u vendos të nisej me një nënshkrim (Lippich, Shkodër 22 qershor 1878); por shkodranët ishin

të vendosur të mos përfillnin shantazhet e valiut në fjalë. Ata rikonfirmuan pjesëmarrjen në Lidhjen e Prizrenit dhe nisjen sa më parë të delegatëve të tyre. Në lidhje me nisjen e delegatëve për në Prizren për tri ditë më radhë në qershor 1878, kemi tri letra:

Më 22 qershor, në raportin nr. 58 nga Shkodra, Lippich shkruan: “Ata (delegatët-M.Gj.) u porositën që t’i mbajnë sytë e hapur dhe të mos pranojnë asgjë që atyre do t’u duket si forcim i rrymës myslimane ose lakmive për epërsinë e islamizmit, por ta mbrojnë me vendosmëri barazinë e plotë midis elementëve myslimanë e katolikë”.

Letra e dytë e datës 23 qershor është po ashtu nga Shkodra, por kësaj here nga reshteri Engjell Çoba, i cili e adreson në dy drejtime: në Prizren dhe Venedik, Baldo Tarabulluzit dhe Stef Biankit. “Ndër këto ditë nisen katër veta në Prezrend, për mu marrë vesh me ato shok e këta shok janë ... e një është prej Malciet të madhe ... se edhe na ketu jena ba turk e latin bashk”.

Letra e tretë vjen nga Prizreni prej konsullit austro-hungarez Jelinek në Prizren. Me këtë letër që mban datën 24 qershor 1878 konsulli i është drejtuar qeverisë së vet, Ministrisë së Jashtme, të cilën e njoftonte se “... nga dita në ditë pritej të vinin delegatët nga viset e Shkodrës dhe të Selanikut”.

Numri i delegatëve të Malësisë nuk ishte i mjaftueshëm, prandaj shumica e krerëve të Malësisë dhe të Mirditës nuk u pajtuan të dërgonin vetëm nga një delegat. Nga Shkodra më 30 qershor 1878 Engjell Çoba përsëri shkruan: “Nuk u pajtuan të dërgonin vetëm 4 veta dhe me këmbënguljen e tyre vendoset që në Prizren të vinin 8 delegatë nga Mbishkodra dhe tre nga Mirdita”. Çoba gjithashtu përmend edhe relacionet e barabarta fetare, të krahinave dhe ato të qytetit, nga të cilat së bashku janë të deleguar 14 veta. Mirëpo, drejtuesi i Konsullatës së Francës në Shkodër, Pons, në letrën dhe raportin nr. 221 që nga Shkodra më 1 korrik 1878 i drejton Vadingtonit, ministrit të Jashtëm të qeverisë së tij, shkruan:

“Zoti Ministër:

“Nëpërmjet kësaj liste e gjithë Malësia e Shkodrës përfaqësohet nga krerët e saj”. Në vazhdim të letrës, në shtojcën numër 222, Pons jep listën e delegatëve shqiptarë në Komitetin e Prizrenit:

Podgorica:	Jusuf Suknik efendiu,
Shkodra:	Selim Tahir beu dhe Jusuf Haxhi Myftari
Malësia e Shkodrës:	Çun Mula, bajraktar i Hotit Zuberi, bajraktar i Reçit Baca Kurti, vojvodë i Grudës Ujk Gila, bajraktar i Selcës Marash Dashi, bajraktar i Shkrelit Gjel Vuksani, bajraktar i Kastratit Mark Lula, bajraktar i Shalës Mark Kola, bajraktar i Shoshit Gegë Gega, vojvodë i Shllakut

dhe tre të Mirditës, për të cilët Pons sqaron “ se ishin xhandarë të paguar nga Qeveria Osmane”. Këto të dhëna i hasim edhe në botime të redaktuara nga Ligor Mile. Ndërkaq, Filip Suma, gjerent i Konsullatës britanike në Shkodër, në lidhje me numrin e delegatëve të Shkodrës, në raportin e 1 korrikut 1878, shkruan: “Delegatët e rrethit të cilët u nisën për në Prizren, më 27 qershor 1878, së bashku me ata të Mirditës nuk ishin 14, por 16 veta...”

Lidhja udhëheq misionin politiko-diplomatik dhe mbrojtjen e tokave nga copëtimi

Lidhja Shqiptare e Prizrenit vazhdon aksionin e vet politik dhe diplomatik në arenën ndërkombëtare, por edhe udhëheq aksionet luftarake për mbrojtjen e trojeve shqiptare. Më 21 shtator 1879 Malësorët i dorëzojnë konsullatës frënge një protestë me përmbajtje të gjerë, shtojcë e letrës së mëparshme nr. 18- "Note de protestion chefs* des regions de Hot de Grud adresse aux Grandes puissances ** Në të, pos tjerash, thuhet: ... Ne përfaqësuesit e Hotit dhe të Grudës jemi kundër aneksimeve të përsëritura malazeze sidomos territorin e Grudës; kjo na është deklaruar disa herë në formë të prerë si nga autoritetet perandorake, ashtu edhe nga përfaqësuesit e fuqive të huaja dhe mike me seli në Shkodër . Në qoftë se fjalët që janë përhapur dhe që po trondisin shpirtërat e banorëve të Hotit dhe Grudës fatkeqësisht do të vërtetohen dhe që edhe pjesa më e vogël e territorit të

sipërpërmendur do t'u hiqet në përfitim të Malit të Zi, atëherë të drejtat e tyre të shenjta do të shkeleshin me këmbë dhe qenia e tyre do të komprometohej, sepse në Hot dhe sidomos në Grudë, nuk do të mbeteshin veçse male shkembore dhe të thata. Nota e potestës përfundon me 26 nënshkrime të "bajraktarëve dhe koxhobashëve", prijësve dhe kryepleqve të Hotit dhe Grudës, në gjuhën frënge (lexo "Aktes de la Ligue du Prizren 1878-1881, f. 129-130 dhe Ligor Mile I, 309-310). Letrën në fjalë konsulli frëng në Shkodër A. le Rese (le Re) ia drejton Ministrit të Jashtëm, Vadigtonit, më 30 shtator 1879, me titullin "Krerët e Hotit e të Grudes mbi vendosmërinë e Malësorëve për të kundërshtuar çdo lëshim territorial ndaj Malit të Zi".

Një nga aksionet e tjera diplomatike është protesta e Hotit, Kelmendit dhe Kastratit në Shkodër më 1 mars 1880. (Note de protestion de chefs de Hot, de Kelmend, de Kastrat, et de Grude adresse a Lippich, consul d'Austrie he-Hongriea, Shkoder, contre l'invention du gouvernement ottoman de liver ces regions ou Montenegro). Fiset e lartpërmendura duke vënë në dijeni kurdisjet e diplomacisë europiane në dëm të viseve të Malësisë janë të friguara nga aneksimet e përsëritura me përkrahje të Portes, dhe provokimet në fjalë bëjnë që populli i fiseve të përmendura të çohet në kryengritje. Të nënshkruar 13 persona përfaqësues të Hotit, Kelmendit dhe Kastratit. (La Ligue; 37-38)

Më 1 mars 1880 sërish nga Shkodra kemi nota proteste kundër aneksimëve malazeze, mirëpo Protokollit i prillit 1880 dhe programi i Leone Cortit, diplomatit italian, (sipas propozimit të tij ndonëse nuk bien Plava dhe Gucia "u mbrojtën") vendosën që si kompensim Malit të Zi t'i jepen viset e fiseve të Grudës dhe pjesa më e madhe e Hotit. Qeveritari i përgjithshëm i Portës së Lartë në Shkodër, Izet Pasha, më 26 prill 1880 shkruan: "Mbrojtësit e Hotit dhe Grudës pengojnë me armë trupat malazeze të hyjnë në trollin shqiptar", ndërsa De Bort, ambasador i Francës në Vjenë, në një raport drejtuar ministrit De Fressine (lidhur me letrën nga Parisi) më 26 prill 1880 thekson: "Konflikti .. për Hotin e Grudën mund të zgjerojë lëvizjen për autonominë e Shqipërisë". Viojnë letrat e shumta diplomatike: ministri i Jashtëm i Francës, De Frisni, nga Parisi më 29 prill 1880 i dërgon letër Montolonit, të ngarkuarit me punë të Francës në Stamboll; një letër tjetër që nga Cetina më 28 prill ministri malazez Radoniq ia dërgon Halil beut, përfaqësuesit të Portës në Cetinë, duke i quajtur

forcat e Lidhjes "nizamë", ndonëse sipas "Glas Crnogorca" vetë princi malazez për forcat e Lidhjes thotë se "ishin të forta" (Ligine snage bjehu jake).

Pas sukseseve të Lidhjes në muajin gusht 1880 në Shqipërinë Veriore, edhe në Malësi, merr formë te organizuar lëvizja autonomiste. Këtë e dëshmon edhe letra që konsulli Le Re ia drejton ministrit të Jashtëm të Francës De Fressine nga Shkodra më 22 gusht 1880 me titull "Rreth përpjekjeve për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë së Veriut". Ai, veç tjerash, shkruante: "Lidhja kishte ndërmend të kapte gjeneralin e brigadës dhe funksionarët e saj osmanë, t'i dëbonte nga Shkodra dhe të shpallte pavarësinë e kësaj pjese të Shqipërisë; mosvënia në zbatim e këtij projekti lidhet me faktin që krerët e Lidhjes nuk arritën të merreshin vesh menjëherë rreth personit që do të caktohej për drejtimin e kësaj krahine".

Ndonëse mbrojtja e Hotit dhe Grudës nën udhëheqjen e Lidhjes dhe krerëve të saj detyroi zbrapsjen e forcave malazeze, apo siç thotë këngëtari popullor i asaj kohe:

"Pop Ilia i bjen burisë,
kthehu mrapa i thot ushtrisë"

në qarqet ndërkombëtare, por edhe në ato osmane e malazeze, do të paraqitet nevoja e kompensimit me një krahinë tjetër, Ulqinin, i cili do t'i dorëzohet Malit të Zi dhe kështu fillon shtypja graduale e Lidhjes.

Shtypja, internimet dhe likuidimet

Pas disa sukseseve politike, diplomatike-ndërkombëtare, ushtarake etj. në forcën e saj organizuese Lidhja pat krijuar edhe Lëvizjen për të drejta autonomiste. Gjatë muajve maj-tetor 1879 ajo mbajti tri mbledhje, por mbledhjen e tretë të 3 tetorit e ndërpreu Porta e Lartë dhe filloi të ndërmarrë masa kundër Lidhjes dhe krerëve të saj. Porta e Lartë gjithashtu mori një varg masash dhe vetë sulltani më 11 janar 1881 ngarkoi Kurd Ismail pashën që të ndërprente kthesat revolucionare dhe lëvizjet autonomiste shqiptare. Në projektin e tij revidoi planet dhe aktivizoi propozimin e mareshalit Dervish Pasha më 27 dhjetor 1880, të cilit me këtë rast ia dha gradën e kryegjeneralit

dhe kryekomandantit të Rumelisë në pesë vilajete osmane të Ballkanit-Kosovës, Manastirit, Janinës, Shkodrës dhe Selanikut.

Fillet e shtypjes nisin në Shkup më 21 mars 1881, kur në pabesi arrestohen 11 anëtarë të Komitetit të Lidhjes së bashku me kryetarin Jashar bej Shkupin. Pastaj fillojnë luftimet turko-shqiptare në Kosovë. Ushtria osmane e komanduar nga Dervish Pasha sulmon Shtimen, kurse në mbrëmjen e 22 prillit 1881 ai me shtatë gjeneralë të tij dhe 24 batalione hyri në Prizren. Fillojnë operacionet në Gjakovë e vende të tjera, ndërsa krerët e Lidhjes Sulejman Vokshi, Ali Ibra dhe të tjerë kalojnë në Malësi të Gjakovës. Sipas njoftimeve që vinin nga Janina më 7 janar 1881, nënkonsulli i Francës, Viet, kishte lajmëruar për internimin e Abdyl Frashërit. Ministria e Jashme britanike sapo mori lajmin për rënien e Prizrenit, njoftoi konsullin e vet në Shkodër, Kirbi Grin, me qëllim që ky nëpërmjet këtij lajmi të bindte shkodranët për të hequr dorë nga ideja e solidarizimit të tyre me Lidhjen e Prizrenit. Por, siç shkruan Lippich më 29 prill 1881, shkodranët në fillim nuk e besuan lajmin deprimues të 29 prillit 1881 për arrestimin e Abdyl Frashërit, të cilin ata dhe Malësia ishin mësuar ta shihnin si përfaqësuesin më të aftë të Lidhjes.

Vala e arrestimeve dhe internimeve vazhdoi edhe në Shkodër e Malësi. Më 13 dhjetor 1880 Le Re shkruan për internimin e Hodo Sokolit dhe Prenk Bibë Dodës. Në raportin e 23 dhjetorit 1880 dërguar Sen Hilerin lidhur me këtë, ai thotë: "Aktet e dhunës vazhdojnë edhe në Malësi: Kelmend, Shkrel, Hot, Grudë, Kastrat, Losh dhe Mirditë. Dervish pasha bën arrestime të shumta, burgosjen e "krerëve të Malësisë" dhe "parisë myslimane". Në atë vit dhune e arrestimesh në një kafene në Tuz likuidohet Baca Kurti, anëtar i Komitetit të Prizrenit, kurse dy vjet më vonë, më 1883, nga Malësia internohen 13 krerë në vendin Diarbekir, prej të cilëve vetëm njëri, Ujkë D. Kalaj, kthehet në Malësi. Sipas fjalëve të tij, përkatësisht tregimeve të popullit, ai kishte parë varrosjen e të 12 bashkëvendësve të tij.

Mr. Mark K. GJOKAJ

**MALËSIA E MADHE IN TIMES OF THE ALBANIAN
LEAGUE OF PRIZREN**

SUMMARY

The representatives of Malësia (Highland region) together with the Shkodra representatives from the first days confirmed their participation in the League of Prizren, which was founded in Eastern Crisis time and in unfavorable, complicated international circumstances for Albanians.

The Albanian League led political activities by organizing the defense of the country. In the international arena, the League informed through protests and memorandums addressed to international organizations and institutions or the Great Powers, about injustices going on against Albanians, with partition of their ethnical territories.

Union of Malësia on all activities of the League, bounded by its given word (besa), showed the force of highlander's promise, and just like in other Albanian lands it suffered from the violent force, eliminations, deportments and imprisonments.